



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Nr. Prot 328

Tiranë, më 03 Korrik 2024

**Drejtuar:** Z. Fatmir Xhafaj  
Kryetar i Komisionit  
Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Mirëqeverisjen,  
Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit

**Nga:** Znj. Erida Skëndaj  
Drejtore Ekzekutive  
Komiteti Shqiptar i Helsinkit

**Lënda:** Kthim përgjigje ftesës për bashkëpunim

*I nderuar Zoti Xhafaj,*

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) është njohur me shkresën Tuaj, me lëndë “Ftesë për Bashkëpunim”, me nr.prot 2609, dt. 28.06.2024.

KShH gjen rastin t’ju falenderojë për ftesën e dërguar dhe vlerësimin ndaj organizatës tonë për kontributin modest që ka dhënë në fushat e mirëqeverisjes, antikorrupsionit si dhe sundimit të ligjit. Gjithashtu ne vlerësojmë rëndësinë që kanë këto tre fusha kanë në drejtim të forcimit të shtetit ligjor dhe demokracisë, rritjes së besimit të qytetarëve tek institucionet dhe zbatimi i drejtë i ligjit si dhe ndikimin e tyre në procesin e integritimit evropian.

Megjithatë, KShH dëshiron t’ju bëj me dije se për shkak të burimeve të kufizuara njerëzore nuk disponon ekspertë me përvojë apo ekspertë të rinj që mund të japin kontribute cilësore, të vazhdueshme dhe sistematike në strukturat e punës që do të ngrihen për të asistuar e mbështetur punën e Komisionit të Posaçëm Parlamentar që Ju drejtoni.

Pavarësisht se KShH nuk mund të përfaqësohet në këto struktura të ekspertëve të nivelit të lartë apo sekretariatit teknik, duke patur në konsideratë misionin dhe funksionin e organizatës tonë shprehim interesin për t’u angazhuar duke kontribuar modestisht në dhënien e mendimeve apo sugjerimeve, nëse kjo do të vlerësohet nga Komisioni, për aktet dhe dokumentet që do të përgatiten nga strukturat mbështetëse. Kjo praktikë konsultimi është ndjekur edhe në vitet e kaluara me



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

Komisionet e tjera Parlamentare, duke përfshirë Komisionin e Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi.

KShH angazhohet gjithashtu për t'ju vendosur në dispozicion në rrugë elektronike pranë pikës Tuaj të kontaktit, raportet studimore dhe raportet tona të monitorimit të realizuara në harkun e pesë vjeçarit të fundit dhe që do të vlerësohen se kanë interes për t'ju njohur nga strukturat mbështetëse të Komisionit të Posaçëm, konform objektit të veprimtarisë së tij.

Duke j' u falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm!

**Me konsideratë,**

**Erida Skëndaj**

**Drejtoreshë Ekzekutive**

